

NE SI QYTETARË AKTIV



POPULLI UDHËHEQËS

AGNESA (11), VENIS (10), BLEART (10), YLLZA (10), ERONITA (10), GRETA (10), ANILA (10)



Ne fëmijët e klasës V-2 sot kemi mësuar për demokracinë dhe do t'iu tregojmë në këtë artikull gjërat që kemi mësuar ne

Demokracia është shfaqur për herë të parë në Greqi, më saktësisht në kryeqytetin e saj, në Athinë. Viti kur kjo ndodhi ishte viti 507 para lindjes së Krishtit. Fjala „demos“ nga greqishtja do të thotë popull, kurse „kratia“ në gjuhën shqipe do të thotë udhëheqje. Pra, demokracia do të thotë popull udhëheqës. Ne mendojmë se çdo popull duhet të ketë demokraci sepse pa demokraci populli nuk mund të udhëhiqet në mënyrë të drejtë.

Ne biseduam se çdo qytetar në demokraci ka të drejtën për të votuar, por atë mund ta shpreh vetëm mbi moshën 18 vjeçare. Në demokraci ekzistojnë ligjet. Ligjet janë rregulla dhe obligime të çdo qytetari në demokraci.

Edhe ne kemi rregulla që duhet t'i respektojmë. Në

shkollë nuk duhet të vrapojmë, nuk duhet të hedhim mbeturina në klasë, duhet të respektojmë mësuesën dhe shokët, dhe as nuk duhet të rrahemi me njëri-tjetrin. Në shtëpi duhet të pastrojmë dhomën, të ndihmojmë anëtarët e tjerë të familjes dhe duhet t'i ndihmojmë prindërve për punët e shtëpisë.


Ne, po ashtu në demokraci duhet të jemi të gjithë të barabartë. Pavarësisht gjuhës që flasim, ngjyrës së lëkurës, apo gjinisë që kemi, ne jemi të gjithë të barabartë. Gjithashtu duhet të kemi respekt. Respekti duhet të ekzistoj te secili qytetar aktiv dhe i përgjegjshëm.

Ne kemi edhe të drejta, detyra e shumë përgjegjësi. Të drejtat tona janë të shumta, por ndër to janë: e drejta për tu shprehur, për të votuar etj. Përgjegjësitë janë obligime që duhet kryer patjetër, e ndërsa të drejtat nuk obligohesh t'i shfrytëzosh.

Nëse ne populli ynë, nuk kemi respektin ndaj njëritjetrit, atëherë populli ynë nuk mund të ishte një shtet i përparuar.



Gazetarët që shkruajtëm artikullin



Ne duhet të respektojmë rregullat e komunikacionit

NE ZGJEDHIM ÇDO DITË

YLLI (10), ERA (11), ARZA (10), ELESA (10), DIANA (10), ARTI (10), DIARI (10)



Ne hasim çdo ditë në zgjedhje të ndryshme



Votimin nuk e pengon raca, feja apo kombi



Ne e votojmë atë që e mendojmë si më të mirin



Vota jonë duhet të jetë e lirë

Ne sot mësuam për procesin e zgjedhjeve dhe për votimin

Zgjedhjet janë proces i rëndësishëm, ku populli vendos për përfaqësuesit e vet. Këtë vendim e merr përmes votës. Ne kur të mbushim moshën 18 vjeçare, do të kemi të drejtë të marrim pjesë në procesin e zgjedhjeve sepse ne do të jemi të pjekur dhe të rritur.

Mirëpo, ne zgjedhim çdo ditë. Për shembull: zgjedhim rrobat që i veshim, ushqimin që e konsumojmë, këpucët që na pëlqejnë, librat që i lexojmë, etj.


Ne sot e kuptuam se çfarë do të thotë të votosh. Po ashtu e mësuam se ne Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve e ato janë: zgjedhjet komunale ose lokale si dhe qendrore apo parlamentare. Zgjedhjet komunale janë kur e zgjedhim kryetarin e komunës, ndërsa zgjedhjet parlamentare janë kur e zgjedhim përfaqësuesin ose deputetin tonë. Ne kur të rritemi do të marrim pjesë në zgjedhje sepse vota jonë ka vlerë të madhe.



Autorët e artikullit

KUVENDI - SHTËPIA E POPULLIT

ERZA (10), ELMA (10), ELONA (10), FISNIKU (11), HALIMI (10), SUELA (10), YLLI (10)



Ne si fëmijë jemi të lumtur që Kuvendi përveç që është shtëpia e popullit, po ashtu është institucioni më demokratik

Ne si fëmijë jemi shumë të gëzuar që vendi ynë Kosova ka institucione që të gjithë qytetarëve iu mundëson që të bashkëvendosin për të ardhmen e vendit tonë. Kjo neve na bën shumë të lumtur, sepse edhe ne në të ardhmen do të kemi të drejtë që të vendosim për të mirën e vendit, e këtë do ta bëjmë përmes votës. Nga titulli, ju të dashur lexues u informuat që në këtë artikull do të mësoni disa gjëra më shumë për Kuvendin e Kosovës. Ne e dijmë që ju keni dijeni se si funksionon Kuvendi, por ne menduam se edhe këto informata që do t'i merrni nga ne do të jenë shumë të mirëseardhura për ju. Sot mësuam që Kuvendi është institucioni më demokratik në vendin tonë, sepse të zgjedhurit e popullit të cilët janë deputetët, zgjedhen përmes votave.

Këta deputetë ndryshe quhen përfaqësues të e popullit tonë.

Ne si fëmijë na pëlqen që Kuvendin ta quajmë Shtëpia e Popullit sepse kështu ndihemi më të afërt me të. Shtëpia e Populli (Kuvendi), ka disa funksione si p.sh: miraton buxhetin e Kosovës, miraton ligjet të cilat i propozon Qeveria, por mund t'i propozoj edhe një numër i madh i qytetarëve. Funksion tjetër i Kuvendit është mbikëqyrja që ia bën Qeverisë, ndërsa funksioni më i rëndësishëm sipas neve është përfaqësimi i popullit, sepse këtu qytetarët janë të përfaqësuar nga deputetët. Shtëpia e Popullit (Kuvendi), ka 120 përfaqësues ku 100 i takojnë kombësisë shqiptare, kurse 20 të tjerë i takojnë komuniteteve të tjera jo shumicë. Ne po ndahemi nga ju të dashur lexues, me shpresën që këto informata që ju kemi sjellur t'iu pëlqejnë dhe t'iu ndihmojnë ta kuptoni rëndësinë e Kuvendit.



Këtu kemi vizatuar disa deputetë të ardhshëm



Puna e grupit

BOTA E MBUSHUR ME NJERËZ TË PËRGJEGJSHËM


ERJON (11), VESA (10), ALTIN (10), RINESA (11), ALTON (10), ENIS (10), ENEIDA (11)

Eja futu në botën ku të gjithë kujdesen për ambientin, dhe ku të gjithë kemi tolerancë, dashuri dhe mirëkuptim ndaj njëri-tjetrit

Të gjithë jemi pjesë e një vendi dhe në mënyrë që vendi ynë të përparoj ne duhet të kujdesemi për mjedisin ku jetojmë. Kujdesi për ambientin dhe për vendin ku jetojmë na bën ne qytetarë aktiv.

Nëse në lagjen ku jetojmë ka shumë mbeturina, ne duhet të marrim masa vullnetare për pastrimin e ambientit, duke vendosur shporta mbeturinash, si dhe duke i vetëdijësuar qytetarët për dëmin që shkakton ndotja e ambientit.

Qytetarët aktiv kanë shumë të drejta dhe përgjegjësi që duhet përmbushur. Përgjegjësitë tona janë: të jemi korrekt ndaj punës që kemi, të ndihmojmë ata që kanë nevojë, të mësojmë sa më shumë gjëra të reja, të respektojmë njëri-tjetrin, etj. Të drejtat tona janë shumë të rëndësishme, ku përdoren si pjesë kryesore e demokracisë.



Të gjithë kemi të drejta të barabarta



Ne duhet të jemi të përgjegjshëm



Mbrojtja e ambientit



Ne jemi aktiv në detyrat dhe përgjegjësitë tona



Ne si fëmijë kemi kujdes për mjedisin ku jetojmë



IMPRESUM

demos ti

Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga

TOKA

Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrur pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org